



KOMISIONI EVROPIAN

Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim

Shkup, 22 nëntor 2012

**Konferenca Rajonale "Reformat e Qëndrueshme – drejt
Synimeve BE 2020"**

Shkup, 20 nëntor 2012

**Fjalim i hapjes
z. Stefano Sanino
Drejtor Gjeneral
DG për Zgjerim**

Falënderoj pa masë Kryeministrin Gruevski dhe zëvendës Kryeministren Arifi që janë nikoqirë të kësaj Konference rajonale në Shkup. Kjo është një iniciativë e shkëlqyer që pason nga konferenca e parë e tillë në vjeshtë të vitit 2011. Si e tillë, po bëhet shprehi e mirë ose traditë e re. Ky lloj initiative është më se i mirëseardhur pasi që nxjerr në pah potencialin e madh që ekziston në punën drejt të ardhmes së përbashkët.

Përkundër sfidave kryesore dhe pasigurisë së madhe globale me të cilën përballet Bashkimi Evropian, politika e zgjerimit vazhdon të kontribuojë për paqe, siguri dhe prosperitet në kontinentin tonë.

Për më tepër, Bashkimi Evropian reflekton mbi të ardhmen e tij, dhe është me rëndësi të mbetet i hapur për ato vende të kontinentit tonë që duan të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e projektit tonë të përbashkët demokratik, të ndërtuar në vlerat tona të përbashkëta.

Kroacia është në rrugë për t'u bërë anëtarja e 28 e Bashkimit Evropian, më 1 korrik 2013; negociatat e anëtarësimit kanë filluar me Malin e Zi kurse Serbisë i është dhënë statusi i Kandidates. Vendi jonë nikoqir, Maqedonia, ka arritur progres të shquar me anë të një Dialogu të ri të Nivelit të Lartë për Anëtarësim. Këto janë sinjale të fuqishme të forcës transformuese të politikës sonë të zgjerimit dhe konfirmojnë kredibilitetin e saj. Atëherë kur vendet e zgjerimit japin

rezultate në reformat e tyre, Bashkimi Evropian përmbush premtimet e veta.

Megjithatë, është me rëndësi jetike që vrulli i reformave të mbetet i njëjtë. Tema kryesore e pakos së këtij viti është vënia e sundimit të ligjit në qendër të politikës së zgjerimit. Ne do të vazhdojmë të caktojmë prioritet në punën që përforcon qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, duke përfshirë edhe reformën gjyqësore, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe nxitjen e reformës në administratën publike.

Ne gjithashtu fokusohemi në sundimin e ligjit dhe çështjet e qeverisjes në qasjet inovative të Komisionit për vendet specifike, për tejkalimin e pengesave në procesin e anëtarësimit (HLAD, HLDAP, Dialogjet e strukturuar me BeH, Kosovën).

Sot, dua të theksoj se sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirëfilltë kanë gjithashtu vlerë ekonomike. Kjo është lidhja e rëndësishme me temën Evropa 2020, e cila paraqet kornizën e politikës së BE-së për zhvillim dhe është tema e konferencës së sotme.

Gjendja aktuale ekonomike është e vështirë. Përbrenda Bashkimit Evropian, dhe sidomos Eurozonës, kriza ekonomike na shpien drejt mekanizmave të rinj për koordinim ekonomik.

Ballkani Perëndimor nuk është akoma pjesë e këtij koordinimi të vendosur. Mirëpo, është me rëndësi të gjejmë mënyra për t'i njohtuar kandidatet dhe kandidatet potenciale me mekanizmat tonë të politikës ekonomike. Kjo është thelbësore: ekonomitë tona janë të integruara mirë, dhe kriza ka ndikim të madh mbi të gjithë ne.

Përbrenda Bashkimit Evropian, strategjia Evropa 2020 është korniza kryesore politike për zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirës. Si anëtarë të ardhshëm, vendet e zgjerimit janë në krye të listës së partnerëve me të cilët angazhohemi në strategjinë Evropa 2020. Kjo është mundësi e mrekullueshme për të qënë një pjesë e reagimit tonë të përbashkët ndaj krizës. Kjo do t'u sigurojë instrumentet dhe rrjetet të cilat nuk i keni si shtete individuale. Kjo tregon edhe një herë rëndësinë e të qënit pjesë e familjes evropiane.

Për këtë qëllim, ne ofrojmë një dialog të përmirësuar ekonomik; lehtësojmë pjesëmarrjen në programe të BE-së; dhe theksojmë agjendën Evropa 2020 në projekte që do të financohen nga instrumenti për ndihmë para-anëtarësuese (IPA) si në nivel nacional ashtu edhe në atë rajonal.

Sot do të doja të nxjerr në pah dimensionin rajonal. Ne besojmë se një pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes tuaj në Evropa 2020 mund të bëhet me anë të bashkëpunimit rajonal. Ekzistojnë disa arsye për këtë:

- Ju jeni të integruar ekonomikisht përbrenda rajonit të Ballkanit Perëndimor. Tregtia rajonale përfaqëson mesatarisht 20% të tregtisë për çdo vend.

- Vendet e Ballkanit Perëndimor janë në nivel të ngjashëm të zhvillimit ekonomik dhe përballen me sfida të ngjashme, siç është niveli i lartë i papunësisë, politikat e dobëta fiskale, dhe nevoja për të përforcuar sundimin e ligjit. Me trajtimin e përbashkët të këtyre sfidave, mund të jeni më efikasë dhe të siguroni përkrahje më të madhe për reformat e nevojshme.

- Investuesit e huaj shohin Ballkanin Perëndimor si një zonë ekonomike. Ata funksionojnë në disa vende dhe kërkojnë përmirësim të infrastrukturës kufitare. Një vendim i investuesit në një vend mund të ketë reperkusione negative ose pozitive për ekonominë e vendeve fqinje.

Gjatë dy viteve të fundit, keni arritur progres më zhvillimin e këtij komponenti rajonal të strategjisë 2020. Këtë muaj në Tiranë, RCC organizoi një mbledhje me Komitetin e Investimeve të Evropës Juglindore, i cili përbëhet nga ministrat tuaj të ekonomisë. Ata u pajtuan të zhvillojnë Strategjinë e Evropës Juglindore 2020.

Ata miratuan synime të përbashkëta në fushën e tregtisë rajonale, investimit, krijimit të vendeve të punës, inovacionit dhe më me

rëndësi, në fushën e sundimit të ligjit. Synimet dhe qasja kanë përkrahjen e fuqishme të Komisionit. Ne presim me padurim miratimin dhe implementimin e Strategjisë EJM 2020.

Mesazhi kryesor nga kjo pasqyrë e shpejtë është se ruajtja e vrullit të reformave është më e rëndësishme se kurrë më parë. BE-ja po ndryshon dhe anëtarët e ardhshëm të BE-së, kjo do të thotë se duhet të jeni në hap me ndryshimet. Pasi që jemi në Shkup, do të kisha theksuar si shembull të mirë Dialogun e Nivelit të Lartë për Anëtarësim. Komisioni dhe qeveria e Maqedonisë së bashku, themeluan një platformë të re në bazë të dialogut të rregullt dhe të strukturuar. Në bazë të kësaj, qeveria miratoi udhërrëfyesin që ka dhënë rezultate konkrete dhe progres në fushat kyç.

Miratimi i reformave për lirinë e të shprehurit ishte një hap i rëndësishëm përpara. Me dekriminalizimin e shpifjes dhe miratimin e kornizës civile, qeveria ka dërguar sinjal të fuqishëm në angazhimin e vet për vlerat fundamentale. Reforma e kornizës elektorale, para zgjedhjeve lokale në muajin mars, ishte gjithashtu një rezultat i rëndësishëm të cilin e ka realizuar qeveria. Kjo ka sjellur energji të re dhe shikim në përpjekjet tona, dhe Shtetet Anëtare kanë ndjekur punën tonë me interesim të madh. Ka lejuar Komisionin të qartësojë rekomandimet e veta për hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Puna e kryer gjatë këtij viti nga institucionet e Maqedonisë dhe shoqëria e Maqedonisë është shumë me rëndësi. Kisha dashur të theksoj rolin e rëndësishëm të Kryeministrit Gruevski dhe Komisionerit Fyle të cilët e shtynë përpara këtë dialog. Kam shpresa të mëdha se samiti i dhjetorit do të marrë këtë parasysh. Dialogu tregoi se vendi nuk lejoi të zhgënjehet. Përkundrazi, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, vendi punoi për të kthyer Evropën në qendër të agjendës politike. Ruajtja e kësaj fryme do të mundësojë rastin më të mirë për të ecur përpara në Samitin e dhjetorit. Ruajtja e dinamikës së reformave është me rëndësi kryesore dhe ne duhet të përqëndrohemi në sfidat e ardhme.

Përgëzoj komentet e Kryeministrit Gruevski për marrëdhënie të mira fqinjësore. Një nga temat e diskutuara në kuadër të HLAD ishte marrëdhëniet e mira fqinjësore. Ato jna një pjesë integrale e asaj që do të thotë të jesh evropian. Marrëdhëniet e mira fqinjësore janë pjesë themelore e procesit dhe nëse ka probleme ato duhet të zgjidhen. Shtetet-anëtare themeluese të BE-së kanë bërë të njëjtën gjë. BE-ja nuk do të ekzistonte pa kompromisin në mes Gjermanisë dhe Francës. Historia e BE-së, e cila është pak më e gjatë se 50 vjet, është një shembull i rëndësishëm që tregon se si konfliktet shekullore mund të shndërrohen në ndërvarësi dhe miqësi.

Qeveria ka ndërmarrë disa hapa konstruktivë, të cilët tregojnë tendencën e saj për të afruar dhe përmirësuar marrëdhëniet me Greqinë dhe Bullgarinë. Kontaktet dhe korrespondenca mes Ministrisë të Punëve të Jashtme Poposki me kolegët e tij në Bullgari dhe në Greqi, janë hap i rëndësishëm. Është me rëndësi vitale që pas kësaj korrespondence të pasojnë akte konkrete. Puna e mëtejshme në këto dy çështje, vrulli i reformave dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore do t'i sigurojnë Komisionit argumentet më të fuqishme për të mbrojtur me besim Rekomandimin e tij për fillim të negociatave në vitin 2013. Ne punojmë së bashku me të gjitha palët, në mënyrë që të arrijmë konsensus për këtë synim.

Kriza aktuale ekonomike tregon se në Evropë, të gjithë ne i nevojitemi njëri tjetrit dhe për të gjetur zgjidhje të besueshme duhet të punojmë së bashku. Mirëpo, ndërvarësia nënkupton se duhet të tregojmë mirëkuptim konkret dhe respektim të qëndrimit të tjerëve. Rekomandimi i KE-së bazohet në idenë se vendimi për fillimin e anëtarësimit të negociatave do të shtojë mundësitë për zgjidhjen e konfliktit për emrin. Kjo do të tregojë se perspektiva evropiane është reale. Rekomandimi ynë tanimë ka dhënë efekte pozitive; janë realizuar kontakte të shpeshta mes dy palëve. Tani, kjo duhet të ecë përpara pa vonesë. Ndërtimi i dinamikës ka rëndësi thelbësore.

Do të përfundoj me përgëzimin e kësaj konference, e cila demonstroi vlerën e bashkëpunimit rajonal në mes shteteve kandidate dhe kandidateve potenciale. Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë pjesë përbërëse e asaj që do të thotë të jesh "evropian". Si të tilla, ato janë një element thelbësor i procesit të anëtarësimit. Iniciativat e mira si kjo do t'i dërgojnë Brukselit shenjë të mirë kësaj radhe. Në takimin e Shteteve Anëtare në Këshillin e muajit dhjetor, ku do të diskutohet mbi hapat e ardhshëm në procesin e zgjerimit, ato do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë këtij aspekti. Kjo Konferencë do të sigurojë elemente plotësuese për t'i prezantuar në diskutim.